



Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete,  
Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e  
Agjencisë kundër Korrupsionit



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike  
Rr. 'Rexhep Luci'. 10/5  
Prishtinë, 10 000, Kosovë  
Ueb-site: [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)  
E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)  
Tel/fax.: +381 38 227 944

Data: 14 korrik, 2015

Nga: Grupi për Studime Juridike dhe Politike

## REKOMANDIME

### të dala nga diskutimi publik mbi 'Parandalimin e Konfliktit të Interesit' (mbajtur me datë 14 korrik 2015)

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit në bashkëpunim me Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) mbajtën diskutimin publik lidhur me *Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04 L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik*. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi i ndryshimeve të propozuara ligjore si dhe mbledhja e propozimeve të cilat do të mundësonin krijimin e një sistemi efikas të parandalimit të konfliktit të interesit.

Pjesëmarrës në këtë diskutim, përveç anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, ishin përfaqësues të agjencive ekzekutive, institucioneve ndërkombëtare, përfaqësues të OJQ-ve dhe organizatave me anëtarësi, përfaqësues të institucioneve tjera të zbatimit të ligjit, si dhe medieve.

Në vijim kemi listuar një grup rekomandimesh gjithëpërfshirëse të dala nga diskutimi publik. Duhet sqaruar që komentet dhe rekomandimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Institutit GAP do të dorëzohen në një dokument të veçantë, dhe nuk janë përfshirë në këtë dokument.

#### **Rekomandimi i 1-rë:**

Një numër i madh i përfaqësuesve në diskutim (sidomos Zyrës së BE-së në Kosovë, GLPS, GAP, COHU dhe deputetja nga radhët e LVV-së) u pajtuan që projektligji aktual nuk adreson problemet e identifikuar në parandalimin e konfliktit të interesit si dhe dështon që të vendos mekanizmat e nevojshëm që do e shndërrojnë këtë projektligj në mjet të fuqishëm të parandalimit të korrupsionit në përgjithësi. Duke njohur numrin e madh të çështjeve që ky projektligj do të duhej që të përfshinte, rekomandimi nga përfaqësuesit e përmendur më lartë ishte që projektligji duhet të kthehet në Qeveri, dhe grupi i ardhshëm punues duhet të ndërtoj një draft më cilësorë duke garantuar pjesëmarrjen e institucioneve tjera të zbatimit të ligjit. Drafti i ri duhet doemos të bazohet në një analizë paraprake mbi praktikën e vendeve tjera (atyre me zhvillim të lartë demokratik), modeleve dhe mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe në një vlerësim paraprak të efekteve dhe problemeve që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit.



### ***Rekomandimi i 2-të:***

Duke marrë parasysh që procesi i parandalimit të konfliktit të interesit është thellësisht i lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë dhe atë të parandalimit të korrupsionit, dhe suksesi në këtë fushë varet nga modeli i shpërndarjes së kompetencave/përgjegjësi në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit (veçanërisht agjencive ekzekutive), ndryshimet në ligjin bazik për parandalimin e interesit duhet medoemos që paralelisht të përfshijë edhe ndryshimin e ligjeve tjera. Këto ndryshime (që duhet të përfshinë një pako ligjesh) janë parakusht për vendosjen e një sistemi efikas të parandalimit të konfliktit të interesit dhe luftimit të korrupsionit.

### ***Rekomandimi i 3-të (mbi përmbajtjen e projekt-ligjit):***

Në diskutim u rekomandua që termi ‘i afërt’ duhet të ri-definohet duke garantuar që projektligji të përcaktoj qartazi lidhjet familjare ose shoqërore të zyrtarit të lartë publik me një palë tjetër, rastet kur interesi publik i zyrtarit të lartë publik bie ndesh me interesin privat të tij dhe/ose apo me interesin e një të afërmi të tij. Natyrisht kufijtë e lidhjes familjare dhe asaj shoqërore duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe të përfshijnë në masë të arsyeshme lidhjet të cilat mund të prodhojnë situatë të konfliktit të interesit në mes të zyrtarit publik dhe palës së përfshirë.

### ***Rekomandimi i 4-të (mbi përmbajtjen e projekt-ligjit):***

Kufizimi i listës së zyrtarëve publik që janë të detyruar që të pastrohen nga konflikt i interesit, duke përjashtuar drejtpërdrejt këshilltarët politik është konsideruar si një e metë e madhe e projektligjit. Andaj, rekomandim i veçantë nga ky diskutim ishte poashtu që lista e zyrtarëve të lartë publikë të përfshijë edhe këshilltarët politik.

### ***Rekomandimi i 5-të (mbi përmbajtjen e projekt-ligjit):***

Një rekomandim tjetër i dalë nga diskutimi publik ka të bëjë me pamundësinë që deklarimi i konfliktit të interesit të mbetet krejtësisht në diskrecion të zyrtarit të lartë publik. Prosesi i deklarimit të një konflikti të interesit duhet të jetë obligim ligjor dhe mos-raportimi i tij i ndëshkueshëm. Ligji bazik nuk i obligon ushtruesit e funksioneve publike që në mënyrë sistematike të deklarojnë dyshimet e tyre lidhur me rastet e konfliktit të interesit, duke e lënë një gjë të tillë në diskrecionin të vetë ushtruesve të funksioneve publike. Një rregullim i tillë në praktikë rrezikon t'i kontribuojë edhe më tej praktikave korruptive në Kosovë.

### ***Rekomandimi i 6-të (mbi përmbajtjen e projekt-ligjit):***

Rekomandim tjetër i veçantë i dal nga diskutimi publik ishte që projektligji nuk duhet të kufizohet vetëm në parandalimin e konfliktit të interesit në relacionin institucion publik v.s institucion publik, por duhet të zgjerohet dhe qartazi të përfshij atë raport të zyrtarit të institucionit publik dhe interesit privat.

### ***Rekomandimi i 7-të (mbi përmbajtjen e projekt-ligjit):***

Rekomandim i radhës ka të bëjë me zgjedhimin/zbërthimin e kuptimit të termit “zyrtarë i lartë publik”. Sipas këtij rekomandimi zyrtarët e lartë publik duhet kategorizuar në linjë me nivelet e ndryshme hierarkike të zyrtarëve në përputhje me pozicionin e tyre brenda administratës shtetërore. Kjo gjë do të mundësojë që procesi i parandalimit të konfliktit të jetë më i dukshëm dhe më dinamik në radhët e zyrtarëve që mbajnë pozicione të rëndësishme vendimmarrëse dhe anasjelltas.



## **TË TJERA:**

1. U propozua që Agjencia Kundër Korrupsionit do të duhej të paraqesë një analizë e cila do të identifikojë të metat e ligjit bazik si dhe sfidat në lidhje me zbatimin e tij në praktikë. U vlerësuar poashtu se agjencitë e ndryshme duhet të rrisin bashkëpunimin dhe mbështetjen e ndërsjellët. Ky bashkëpunim do të kontribuonte, përveç tjerash, edhe në harmonizimin e të dhënave dhe informatave të grumbulluara, si dhe për të koordinuar veprimet që lidhen me të njëjtat raste, nga agjenci të ndryshme.
2. Përfaqësuesi nga Agjencia Kundër Korrupsionit ngriti shqetësimin që shumë nga rekomandimet e saj mbi projektligjin nuk ishin marrë parasysh apo inkorporuar në tekstin e projektligjit.
3. U ritheksua nevoja për harmonizimin e ligjit në fjalë me Kodin Penal si dhe harmonizimin me Ligjin për Deklarimin e Aseteve. Sqarim: Mos zbatimi i këtij ligji ka për pasojë dënimet në të holla të cilat varojnë prej 500 Euro deri në 2,500 Euro, si dhe ndalimin e ushtrimit të funksionit publik për periudhën kohore prej 3 deri në 12 muaj. Shkeljet e këtij ligji nuk konsiderohen vepra penale por kundërvajtje dhe dënohet me gjobë. Megjithatë, Kodi i ri Penal i Kosovës i cili hyri në fuqi në vitin 2013, shkeljet e grupit të rregullave të konfliktit të interesit i klasifikon si vepra penale.

